



Pengimi në raportimin medial - pasqyrë e perceptimeve shoqërore

Gjetje paraprake nga monitorimi
i mediave rreth përfshirjes
dhe mënyrës së raportimit për
personat me pengim

Autorë:
Vesna Nikodinoska
Vllado Kërstovski

Autorë:

Vesna Nikodinoska
Vllado Kërstovski

Metodologjia: Verica Rupar

Hulumtues:

Vllado Kërstovski
Vasillka Dimoska
Maja Gacoska

Përktheu në gjuhën shqipe:

Nazif Zejnullahu

Disenji: Millosh Petrov

.....

Ky publikim është përgatitur nga Instituti i Diversitetit të Medias (MDI), Media Instituti Maqedoni (MIM) dhe Këshilli Nacional i Organizatave Invalidore të Maqedonisë (KNOIM), si pjesë e projektit “Pengimi është çështje e perceptimit”, që është financuar nga Bashkimi Evropian.



.....



Ky publikim është i përgatitur me mbështetje financiare nga Bashkimi Evropian. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi vetëm e Institutit të Diversitetit të Medias (MDI) dhe në asnjë mënyrë nuk i pasqyron pikëpamjet e Bashkimit Evropian.



Pengimi në raportimin medial - pasqyrë e perceptimeve shoqërore

Gjetje paraprake nga monitorimi
i mediave rreth përfshirjes
dhe mënyrës së raportimit për
personat me pengim



Përmbajtje

1. Hyrje	06
2. Për projektin „Pengimi është çështje e perceptimit“	09
3. Objektivi i hulumtimit dhe metodologjia	12
4. Monitorimi i mediave: numër i vogël i përmbajtjeve ku janë të pranishëm personat me pengim	13
5. Gjetje bazë nga intervistat e kryera	21
6. Rekomandime	27

1. Hyrje

Politikat sociale për përmirësimin e pozitës së personave me pengim kanë përjetuar ndryshime thelbësore në nivel ndërkombëtar gjatë dy dekadave të kaluara. Kjo ka rezultuar me përparimin e legjislacionit dhe të kuadrit institucional në nivel evropian dhe nacional, që e përfshin konceptin e inkluzionit social dhe pjesëmarrjen e njëjtë të personave me pengim në zhvillimin e jetës së përditshme, mbi bazë të njëjtë, me qytetarët tjerë. Paraqitja adekuate e personave me pengim në zhvillimin e mediave dhe ngritja e vetëdijes publike për çështje që lidhen me ta, gjithashtu kanë ndikim të rëndësishëm në krijimin e perceptimeve të përgjithshme për këta persona.

Pengimi sot shikohet në prizmin e të drejtave të njeriut, përkatësisht të njohjes së të drejtës themelore të personave me pengim që ata të marrin pjesë në mënyrë të plotë në jetën sociale, kulturore, politike dhe ekonomike të bashkësisë. Shtetet duhet të zhvillojnë politika të forta sociale dhe politika për inkluzion social, të cilat doemos duhet të përfshijnë aspekte në lidhje me personat me pengim. Një pjesë e rëndësishme e këtyre synimeve është ngritja e vetëdijes publike për të drejtat dhe mundësitë e personave me pengim dhe ndryshimi i mënyrës se si i perceptojnë ata të tjerët. Rol të madh në këtë kanë mediat, të cilat i portretojnë personat me pengim dhe raportojnë për çështjet që lidhen me të drejtat e tyre të njeriut. Edhe krahas kësaj, këta qytetarë ende janë njëri prej grupeve më të marginalizuara: shumë prej tyre nuk kanë qasje të njëjtë tek mbrojtja shëndetësore, tek arsimi, punësimi, bile as tek ofruesit e shërbimeve sociale të cilat ndërlidhen me pengimin e tyre. Paragjykimet e rrethit janë faktor plotësues, që e rëndon pozitën e tyre në shoqëri.

Në Republikën e Maqedonisë së Veriut viteve të fundit ka më shumë iniciativa për përparimin e të drejtave të personave me pengim në kuadër të sektorëve: mbrojtje sociale, deinstitutionalizim dhe arsim. Obligimet që janë marrë me ratifikimin e Konventës për të Drejtat e Personave me Pengim të Kombeve të Bashkuara në vitin 2011, janë integruar në strategjitë për zhvillimin e veprimtarisë audio dhe audiovizive, për deinstitutionalizim, për arsim dhe për mosdiskriminim. Prej dokumenteve të tjera ndërkombëtare, të rëndësishme janë vërejtjet përfundimtare të cilat Komiteti për të Drejtat e Personave me Pengim i KB ua drejtoi institucioneve kompetente të shtetit tonë gjatë shqyrtimit të raportit shtetëror inicial për implementimin e Konventës (shtator 2019). Komiteti numëroi shqetësimet e ngritura për shkak të mungesës së politikës dhe të strategjisë nacionale për ngritjen e vetëdijes për pengesat në zhvillim dhe për përpjekjet e pamjaftueshme për pengimin dhe zhvillimin e luftës kundër stereotipeve për pengimin dhe diskriminimin mbi këtë bazë, konstatoi ekzistimin e vetëm aktiviteteve ad hoc për ngritjen e vetëdijes, të cilat fokusohen vetëm tek dëmtimi, në vend se të drejtat, të cilat e forcojnë qasjen mëshiruese ndaj pengimit. Për këtë shkak, Komiteti rekomandoi që shteti të miratojë politikë dhe strategji nacionale për ngritjen e vetëdijes për pengimin, me qëllim frenimin dhe luftimin e diskriminimit që kanë përjetuar personat me pengim, përmes pjesëmarrjes së personave me pengim, luftës së drejtuar kundër stigmës dhe stereotipeve, si dhe zhvillimin e fushatave të vazhdueshme për Konventën në sektorin publik dhe privat dhe midis personave me pengim dhe organizatave të tyre reprezentative. Komiteti, gjithashtu, ka rekomanduar që shteti të mendojë për miratimin e ligjit për të drejtën e qasjes tek informacionet dhe për eliminimin e çfarëdo lloji pengimi që i frenon personat me pengim që lirisht të kërkojnë, të pranojnë dhe të transmetojnë informacione dhe ide mbi bazë të njëjtë me të tjerët, përfshi edhe platformat on-line.

Si përgjigje ndaj rekomandimeve të Komitetit për të Drejtat e Personave me Pengim të KB, Trupi Koordinues Nacional për Implementimin e Konventës së KB në vitin 2019 parashikoi disa masa për realizim, të cilat duhet të zbatohen në bashkëpunim me Ministrinë e Shoqërisë Informative dhe të Administratës, Agjencinë për Komunikime Elektronike, Agjencinë e Radiodifuzionit dhe Shoqatën e Gazetarëve të Maqedonisë. Masat e propozuara përfshijnë: sensibilizimin e rregullatorëve medialë për të drejtat dhe nevojat e personave me pengim, edukimin e radiopërhapësve për të drejtat e personave me pengim, fushata të vazhdueshme për ngritjen e vetëdijes për të drejtat e personave me pengim, përdëftime drejtuar mediave që ueb-faqet e tyre të jenë në formatin e arritshëm.

Agjencia e Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizive në vitin 2019 e përgatiti Strategjinë rregullatore për zhvillimin e veprimtarisë audio dhe audiovizive (2019-2023), me qëllim që t'i përcaktojë kahet e veprimit të vet dhe të përmirësimit të një numri të madh të aspekteve nga sfera e mediave. Në pjesën me titull "Mbrojtja e të drejtave të njeriut tek përmbajtjet mediale", është paraparë një kapitull të tërë: "Zgjerimi i qasjes tek shërbimet dhe përmbajtjet mediale", që ka të bëjë me personat me pengim, sidomos të personave me shikim të dëmtuar dhe me dëgjim të dëmtuar.

Me Ligjin e ri për pengim dhe mbrojtje nga diskriminimi, të vitit 2019, zgjerohen bazat e diskriminimit, më mirë definohet diskriminimi, ndërsa profesionalizohet edhe Komisioni për Mbrojtje nga Diskriminimi, i cili do të duhet të punojë edhe tek preventiva, përveç se në mbrojtje nga diskriminimi. Pengimi në zhvillim është treguar drejtpërdrejt si bazë diskriminuese, ndërsa në definicionin e diskriminimit është përfshirë edhe pamundësia për qasje dhe arritje të infrastrukturës, të të mirave dhe të shërbimeve.

Me strategjinë nacionale për deinstitutionalizim "Тимјаник" (Trumëz) 2018-2027, është paraparë transformimi i sistemit të kujdesit institucional drejt sistemit të kujdesjes sociale në familje dhe në bashkësi me mbështetjen e shërbimeve sociale, përkatësisht mbylljen e institucioneve dhe zhvillimin e njëkohshëm të shërbimeve sociale në kuadër të bashkësisë, funksioni i të cilit (zhvillim) bazohet në standardet për të drejtat e njeriut.

Në Strategjinë për arsim 2018 - 2025, shteti do të angazhohet që të sigurojë arsim gjithëpërfshirës, inkluziv dhe të integruar për të gjithë nxënësit, ndërsa një pjesë e prioritetëve janë drejtuar kah rritja e përfshirjes së fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore në arsimin parashkollor, fillor, të mesëm dhe të lartë.

2. Për projektin „Pengimi është çështje e perceptimit“

Projektin “Pengimi është çështje e perceptimit” e bën Instituti për Media dhe Dallime (Media Diversity Institute) nga Londra, bashkë me Media Institutin Maqedoni dhe me Këshillin Nacional të Organizatave Invalidore të Maqedonisë, me qëllim: forcimin e dukjes së personave me pengim në media. Projekti dukjen e personave me pengim në media e shih si parakusht të domosdoshëm për pjesëmarrje të tyre aktive në jetën publike dhe trajtim të njëjtë në realizimin e të drejtave dhe lirive. Disenji i projektit është përgjigje ndaj rrethit ku roli i dobësuar i mediave si mbrojtës të interesit publik në Maqedoninë e Veriut, nga njëra anë, dhe klima e rëndë në të cilën punojnë organizatat qytetare, nga ana tjetër, e ngushtuan hapësirën mediale për nevojat urgjente të grupeve të rrezikuara, duke ndikuar në perceptimet e gabuara të qytetarëve në njohjen e diskriminimit ekzistues.

Në mungesë të raportimit cilësor, perceptimi për personat me pengim, dhe për nevojat e tyre, mbetet në mënyrë dominante subjektiv dhe që u nënshtrohet paragjyqimeve, e me këtë shpesh edhe kundërproduktiv. „Padukshmëria“ e personave me pengim në media e pengon pjesëmarrjen e tyre të vërtetë në jetën publike dhe praktikimin e plotë të të drejtave të tyre të njeriut dhe të inkluzionit social. Për këtë shkak projekti kishte për objektiv që të ofrojë zgjidhje dhe të sigurojë parakushte për uljen e “pengimit” të personave me pengim në media, përmes:

- Rritjes së efektivitetit të organizatave qytetare që i përfaqësojnë personat me pengim përmes nxitjes që qasjes aktive në komunikimin me mediat;
- Përparimit të të kuptuarit dhe të shkathtësive për praktimin e gazetarisë inkluzive nga ana e gazetarëve;
- Vënies në një agjendë më të lartë politike të temave që lidhen me “padukshmërinë” e personave me pengim në media.

Partnerët në projekt u përcaktuan për qasje “participuese” - sensitivimin dhe forcimin e kapaciteteve të të gjitha palëve të prekura, sigurimin e bashkëpunimit të qëndrueshëm me shumë sektorësh dhe ngritjen e vetëdijes publike. Qëllimi ishte që të përfshihen të gjitha grupet dhe aktorët e synuar, duke stimuluar bashkimin e resurseve ekzistuese, të potencialeve të brendshme dhe duke nxitur bashkëpunimin.

Projekti kontribuoi drejt përmirësimit të shkathtësive dhe të dijeve të të dyja palëve të prekura kyç, duke i nxitur nga njëra anë **gazetarët** që të raportojnë për pengimin duke i respektuar parimet e gazetarisë inkluzive, ndërsa nga ana tjetër, **organizatat qytetare që i përfaqësojnë personat me pengim** - të komunikojnë me mediat në mënyrë më efektive, përmes shfrytëzimit edhe të mediave tradicionale edhe të reja, me qëllim që të depërtojnë te publiku dhe ta ngrenë vetëdijen për gjendjen me të drejtat e personave me pengim.

Plus kësaj, projekti kishte për objektiva ta forcojë bashkëpunimin midis këtyre dy palëve të prekura dhe t’u ndihmojë që të krijojnë relacione afatgjatë. Të gjitha aktivitetet e projektit çonin drejt ngritjes së vetëdijes në **publik** për kërkesat dhe të drejtat e personave me pengim përmes prodhimit të përmbajtjeve të ndryshme mediale, aktiviteteteve të mediave sociale dhe iniciativave të organizatave të vogla që punojnë në bashkësitë e tyre. Projekti ka adresuar edhe **kreatorët e politikave**, sidomos përmes *Rekomandimeve për politika*, që kanë të bëjnë me përmirësimin e politikave për të drejtat e personave me pengim, sidomos në sferën mediale, me qëllim që të adresohet raportimi i pamjaftueshëm medial për personat me pengim. Ato ishin përndarë me **bartësit e vendimeve** në konferencën e mbajtur me rastin e shënimit të Ditës Ndërkombëtare të të Drejtave të Personave me Pengim. **Personat me pengim** kishin rastin që përmes projektit ta përmirësojnë të kuptuarit e publikut për temat që e prekin atë dhe të mundësojnë që sektori publik dhe individualistët të jenë më efikasë gjatë përfaqësimit të të drejtave të personave me pengim.

Me qëllim që të kontribuojnë në shtimin e diturive dhe të resurseve për këtë temë, partnerët në projekt e nxorën edhe doracakun „*Pengimi: Në dritë*” kushtuar organizatave qytetare që i përfaqësojnë personat me pengim. Kjo analizë, gjithashtu, kontribuon në

drejtim të të kuptuarit më të mirë të gjendjes aktuale dhe mund të japë kahe për aktivitetet vijuese në këtë sferë. Platforma on-line www.aktiv.mk shërben si pikë resursi për të gjitha dokumentet, lajmet dhe informacionet për aktivitetet e përgatitura gjatë kohës së implementimit të projektit.

Projekti “Pengimi është çështje e perceptimit” është financuar nga Delegacioni i Bashkimit Evropian në Maqedoninë e Veriut, në kohëzgjatje nga janari 2018 deri në janar 2020.



3. Objektivi i hulumtimit dhe metodologjia

Analiza ka për objektiv të konstatojë përfshirjen dhe mënyrën e raportimit të mediave për personat me pengim. Në këtë drejtim ishte bërë monitorimi i nëntë mediave në gjuhën maqedonase dhe shqipe: Sllloboden pečat, TV Sitel, TV Telma, TV Tera, SDK.mk, TV Alsat-M në gjuhën shqipe, TV Koha, gazeta Koha dhe portalb.mk¹ në periudhën prej 1 deri më 30 shtator 2019. Mediat ishin zgjedhur mbi bazë të shikueshmërisë/dëgjueshmërisë dhe ndikimit të tyre që kanë tek publiku. Te televizionet ishin monitoruar edicionet informative qendrore, ndërsa te gazetatat ose te mediat on-line janë shikuar të gjitha rubrikat, përveç atyre për zhvillimet jashtë shtetit, për argëtim dhe për sport. Plus kësaj, ishin bërë edhe 18 intervista të thelluara me përfaqësues të institucioneve, të organizatave qytetare dhe të mediave, me qëllim që të hulumtohen qëndrimet, përvojat dhe praktikatat ekzistuese të bashkëpunimit midis aktorëve të ndryshëm, të jepen propozime për përparimin e mekanizmave të bashkëpunimit midis tyre dhe në atë mënyrë të kontribuohet drejt përfshirjes më të madhe të personave me pengim në media.

¹ Sllloboden pečat është gazetë ditore në gjuhën maqedonase, e cila ka tirazh më të madh në mesin e gazetave ditore në shtet (www.slllobodenpecat.mk), ndërsa gazeta Koha në gjuhën shqipe është gazeta me tirazh më të madh në gjuhën shqipe (www.koha.mk); TV Sitel është televizion terrestrial (tokësor) me emetim në nivel nacional dhe ka shikueshmëri më të madhe (24,24%, sipas Media Sustainability Index, MSI 2018); TV Alsat-M është televizion terrestrial me emetim në nivel nacional, në gjuhën shqipe dhe maqedonase dhe ka shikueshmëri 5,44% (sipas MSI 2018); TV Telma është televizion terrestrial me emetim në nivel nacional, ka politikë redaktuese konzistente dhe neutrale (shikueshmëri 3,57%, sipas MSI 2018); TV Koha është televizion rajonal në gjuhën shqipe (pjesëmarrja në shikueshmërinë në rajon – 5,07% dhe në shikueshmërinë e përgjithshme – 0,58%) dhe TV Tera është televizion rajonal në gjuhën maqedonase (pjesëmarrja në shikueshmërinë në rajon – 2,85% dhe në shikueshmërinë e përgjithshme – 0,46%) (të dhënat për televizionet rajonale janë marrë nga Hulumtimet e Agjencisë së Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizive, 2019); SDK.mk dhe Portalb.mk janë portale në gjuhën maqedonase dhe në gjuhën shqipe, të cilat ofrojnë përmbajtje informative dhe kanë shtrirje domethënëse të shfrytëzuesit.

4. Monitorimi i mediave: numër i vogël i përmbajtjeve ku janë të pranishëm personat me pengim

Analiza e të dhënave nga monitorimi ishte bërë në dy faza: së pari, në periudhën 1-15 tetor 2019, në mediat e monitoruara ishin ndarë të gjitha tekstet dhe kontributet që kanë të bëjnë me tema që lidhen me grupe të ndjeshme dhe të marginalizuara, përkatësisht me tema që e adresojnë pengimin (invaliditetin), përkatësinë etnike, religjionin, gjininë, orientimin seksual ose moshën. Nga ky “universum” kontributesh dhe tekstesh, në fazën e dytë hulumtimi ishte fokusuar vetëm në ato përmbajtje që kanë të bëjnë me pengimin dhe ato ishin analizuar në mënyrë më të detajuar në periudhën nga 15 tetori deri në 1 dhjetor 2019.

Në fazën e parë ishte përcaktuar që në të gjitha pesë mediat në gjuhën maqedonase ishin publikuar 96 kontribute, ndërsa në gjuhën shqipe 80 tekste të lidhura me aspektet pengim (invaliditet), përkatësi nacionale, religjion, gjini, orientim seksual, vjeç/moshë.

Tabela 1.	Mediat në gjuhën maqedonase	Mediat në gjuhën shqipe
Faza I (pengim, përkatësi etnike, religjion, gjini, orientim seksual, vjeç/moshë)	96	80
Faza II (kontribute/tekste me temë pengimin)	38	6

Me këtë rast, në periudhën e monitoruar nga mediat në gjuhën maqedonase më shumë tekste lidhur me grupet e ndjeshme dhe të marginalizuara kanë publikuar televizioni terrestrial nacional Sitel (23) dhe TV Tera rajonale (22). TV Sitel në lajmet e veta zakonisht hapësirë u jep rrëfenjave sociale nga i tërë vendi, të cilat mbulojnë edhe tema që janë me interes për këtë analizë, ndërsa shumica e kontributeve të emetuara në TV Tera janë informacione me adresim nga rajoni ku rrezaton televizioni. Numër i ngjashëm kontributesh dhe tekstesh ishin publikuar në portalin SDK.mk (19), në TV Telma terrestre nationale (17) dhe në gazetën Sloboden pečat (15), media të cilat janë me shtrirje nacionale dhe që rregullisht publikojnë informacione për këto grupe qytetarësh. Pjesa dominante e përmbajtjeve, përveç se me pengimin, kanë qenë me referenca dhe me tema të lidhura me moshën, me përkatësinë etnike dhe me gjininë. Në mediat në gjuhën shqipe në fazën e parë më shumë tekste për grupet e ndjeshme dhe të marginalizuara kishte publikuar gazeta Koha (28), pastaj TV Alsat-M (21 kontribute), Portalb.mk (20), ndërsa në TV Koha, ndërkaq -11 kontribute. Pjesa më e madhe e kontributeve dhe temave të publikuara ishin me temë-përkatësia etnike, gjinia, moshja dhe religjioni.

Në fazën e dytë, hulumtimi fokusohet në të gjitha tekstet që kishin të bënin ekskluzivisht me pengimin dhe ato në mënyrë më të detajuar ishin analizuar nga aspekti i temës, i burimit të informacionit, i atributimit (si janë përshkruar personat me pengim), ishte analizuar se a ka citat nga personi me pengim dhe cili ishte toni i kontributit/tekstit.

Numri i kontributeve dhe i teksteve të ndara në këtë fazë, që kishin të bënin në mënyrë specifike me pengimin, të publikuara në të nëntë mediat në gjuhën maqedonase dhe shqipe gjatë shtatorit, ka qenë i vogël: në mediat në gjuhën maqedonase mesatarisht janë publikuar nga pesë kontribute, në përjashtim vetëm të disa mediave të cilat ka pasur mbi dhjetë kontribute, ndërsa në mediat në gjuhën shqipe ishin publikuar një deri në dy përmbajtje në periudhën e monitoruar. Në mënyrë më precize, tek mediat në gjuhën maqedonase prej gjithsej 96 teksteve dhe kontributeve, konkretisht 38 përmbajtje kanë qenë në lidhje me pengimin, 43 me moshën, tetë kanë qenë në lidhje me përkatësinë etnike, ndërsa shtatë me gjininë. Tek mediat në gjuhën shqipe, vetëm 6 përmbajtje, nga gjithsej 80, kanë qenë në lidhje me pengimin.

Numri i përmbajtjeve	Media në gjuhën maqedonase	Media në gjuhën shqipe
Pengimi	38	6
Mosha	43	12
Përkatësia etnike	8	42
Gjinia	7	19
Religjioni	0	1
Gjithsej	96	80

4.1. Shëndetësia dhe arsimi - temat më të shpeshta që kanë qenë në lidhje me pengimin

Temat e lidhura me personat me pengim nuk janë shpesh të pranishme në lajme edhe te mediat tjera që ishin monitoruar. Atje ku ishin të pranishme, thuajse në të gjitha rastet, ato më shpesh gjenden në bllokun e dytë të lajmeve në televizione, pas temave ditore-politike, diku madje edhe pas minutës së 20-të. Në periudhën e monitoruar, tek mediat edhe në gjuhën maqedonase edhe në gjuhën shqipe, tek terminet dhe përmbajtjet qendrore dominonin më shumë tema nga politika e lartë, siç janë pritjet për fillimin e bisedimeve me BE-në, skandali me prokuroren e mëparshme të Prokurorisë Publike Speciale, Katica Janeva, bisedimet në kuadër të komisionit të përbashkët midis Maqedonisë dhe Bullgarisë, bisedimet rreth Ligjit për Prokurori Publike, si dhe bisedimet midis Sindikatës dhe Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencës.

Në relacion me personat me pengim, temat shëndetësi dhe arsim më shpesh kanë dominuar te kontributet dhe tekstet e mediave të monitoruara në gjuhën maqedonase gjatë shtatorit, ndërsa pastaj vijonin temat mbrojtje sociale, sport, kulturë dhe politikë. Te mediat në gjuhën shqipe ishin të përfshira temat shëndetësi, argëtim, politikë dhe arsim.

Në fillim të vitit shkollor ishte hapur shkolla e re fillore "Kiro Gligorov" në Shkup, në kuadër të së cilës funksionon edhe qendra ditore për fëmijë me paralizë cerebrale. Kjo ishte ngjarje të cilën e mbuluan më shumë media në gjuhën maqedonase. Në mediat në gjuhën shqipe, një tekst në gazetën "Koha" vetëm në mënyrë indirekte e adresonte këtë temë, duke shpjeguar që në shumë fshatra shqiptare shkollat janë në gjendje katastrofale.

Në lidhje me temën shëndetësi, duhet të theksohet që në media të caktuara me sukses dhe në mënyrë konzistente ndiqen tregime të cilat janë domethënëse për personat me pengim në agjendën ditore të lajmeve. Kështu, rrëfenjën për problemet rreth realizimit të pensionit invalidor të personave me pengim dhe me probleme të tjera shëndetësore të këtyre personave, TV Sitel e mbuloi me tetë kontribute gjatë shtatorit. Televizioni e ndiqte temën nga aspekte të ndryshme, përmes tregimeve të disa qytetarëve të përfshirë, ishin ndërlidhur deklarata nga politikanë relevantë dhe nga institucionet kompetente, me të cilën ata ishin ftuar që të reagojnë dhe të iniciojnë revizionin e kërkesave të kontestuara për realizimin e të drejtës së pensionit invalidor.

Në lidhje me mbrojtjen sociale, kishte vetëm disa përmbajtje, në mesin e të cilave edhe një intervistë me primadonën e operës Vesna Ginovska Illkova, e cila e ka të vëllanë me pengim dhe mban orë për këndim në shtëpinë e njerëzve të rraskapitur (SDK.mk), njerëzve me pengim që kanë talente specifike - pikturojnë, i bien ndonjë instrumenti (TV Telma, TV Sitel), si dhe për mungesën e interpretuesve në gjuhën e shenjave (TV Telma).

Vetëm disa kontribute dhe tekste kishin të bënin me sportin, e ndërlidheshin me arritjet ose me mundësitë që u ofrohen personave me pengim për aktivitete rekreative të caktuara.

Gjatë shtatorit kishte vetëm një kontribut në të cilin temë konkrete ishte politika, e që në mënyrë indirekte është e lidhur me personat me pengim. Ishte shfrytëzuar vizita e Kryetarit të një komune, të cilin gjatë vizitës në Ankara, Turqi, e kishte pritur delegacioni në të cilin ka pasur edhe fëmijë me pengim.

Në sferën e kulturës kishte vetëm dy kontribute në tërë periudhën e monitoruar, si dhe nga një kontribut në lidhje me sigurinë në rrugë për personat me pengim dhe për mundësitë për inkluzion social, të cilat do të ishin hapur gjatë hyrjes së shtetit në Bashkimin Evropian.

Tek mediat e monitoruara në gjuhën shqipe, përmbajtjet e ndara ishin përpunuar në të shumtën përmes zhanreve të shkurtra informative. Temat në kontribute dhe tekste kishin të bënin me shëndetin, me argëtimin, me politikën dhe arsimin, megjithatë asnjëra nuk ndahej mbi bazë të relevancës, duke trajtuar probleme dhe sfida kronike me të cilat ballafaqohen personat me pengim, me të cilën do të dilnin më lart në agjendë në mesin e ngjarjeve ditore të cilat ishin të mbuluara nga media.

Tabela 2.	Media në gjuhën maqedonase	Media në gjuhën shqipe
Tema	Mbrojtje sociale (5) Arsim (11) Sport (6) Politikë (1) Shëndetësi (11) Kulturë (2) Tjetër(2)	Shëndetësi Urbanizëm (2) Politikë Arsim (2)
Burimet e informacioneve	Politikanë (8) Të tjerë (13) Mjekë (2) Persona me pengim (14) OQ (1)	OQ (2) Mjekë Komunë Agjenci nacionale Tjetër (1)
Përshkrimi i personave me pengim	Persona/fëmijë me nevoja të veçanta, invalidë/persona invalidë, hendikep Mosha dhe vendi ku jeton Profesioni, talenti, aftësia (merren me pikturë, bëjnë interpretime në instrumente të ndryshme, ngjitje nëpër male etj.)	Pengim
Citat	Citat të personave me pengim në 13 përmbajtje (nga gjithsej 38)	Citat të personit me pengim në asnjë përmbajtje/tekst (nga gjithsej 6)

4.2. Burime të pamjaftueshme informacionesh në përmbajtjet mediale

Burimet e informacioneve, të konsultuara më shpesh në mediat në gjuhën maqedonase në periudhën e monitoruar, kanë qenë personat me pengim, si dhe anëtarët e familjeve të tyre. Megjithatë, kur flasim për citimin e personave me pengim, duhet të shënohet që te mediat në gjuhën maqedonase ka pasur 13 citate nga gjithsej 38 kontribute dhe tekste që kishin të bënin me këtë kategori qytetarësh, ndërkohë që te mediat në gjuhën shqipe nuk ka pasur asnjë citat në të gjashtë kontributet që kanë pasur të bëjnë me këtë kategori qytetarësh. Citimi i personave me pengim, në kontribute dhe tekste, gjithnjë varet nga lloji i pengimit, që mund të ndikojë te fakti se vetëm në një të tretën e përmbajtjeve ka pasur citate nga këta qytetarë. Por, në më shumë raste mund të vërehet se mungon, përkatësisht se duhet iniciativë plotësuese gazetareske që të merret deklarata nga personi me pengim.

Te burimet e informacioneve, pas personave me pengim të cilët më shumë janë paraqitur në kontribute dhe në tekste, kanë qenë politikanët, si në temat në lidhje me të drejtën e çrregulluar të realizimit të pensionit invalidor, ose të hapjes së shkollës së re fillore "Kiro Gligorov". Në katër raste janë shfrytëzuar informacione nga institucionet. Mjekët kanë qenë burim informacioni vetëm në dy kontribute, ndërsa vetëm nga një herë në media dhe përmbajtje të ndryshme janë konsultuar juristi, ekonomisti, qytetari, organizata qytetare dhe sindikata.

Te mediat në gjuhën shqipe si burime informacioni janë paraqitur organizata qytetare humanitare, e cila ka dhënë donacion për renovimin e parkut për personat me pengim, mjeku, komuna dhe agjencia nacionale.

Nga gjetjet e arritura mund të nxirret si shënim bashkëpunimi i pamjaftueshëm midis mediave dhe organizatave qytetare, përkatësisht fakti se ato nuk janë të njohura si burim ekspertize nga ana e mediave. Kjo është e mbështetur me të dhënën se te të gjitha mediat gjatë shtatorit, vetëm në tri raste organizatat qytetare janë paraqitur si burim informacioni.

4.3. Personat me pengim më shpesh janë përshkruar përmes pengimit të tyre

Në lidhje me përshkrimin e personave me pengim, nga aspekti metodologjik ishin vënë më shumë përcaktorë, siç janë: pengimi, profesioni, mosha dhe vendi i jetesës. Te përmbytjet që i shqyrtoam gjatë përshkrimit të personave me pengim, te mediat edhe në gjuhën maqedonase edhe në gjuhën shqipe më shpesh përdoret pikërisht pengimi, që theksohet menjëherë pas emrit dhe mbiemrit të personit.

Me këtë rast, më shumë media gjatë përshkrimit të këtyre personave ende shfrytëzojnë terminologji, si: invalidë, persona invalidë, persona me invaliditet, persona/fëmijë me nevoja të veçanta ose me hendikep, përkundër termit të unifikuar dhe të gjithë pranuar - persona me pengim.

Mediat shpesh i përshkruajnë personat me pengim sipas viteve dhe vendit ku jetojnë, me ç'rast të dy këta përcaktorë në të shumtën e rasteve kombinohen, pas së cilës ka pasuar edhe përshkrimi i llojit të pengimit („...shkupjani 52-vjeçar nga fundi i vitit të kaluar shfrytëzon edhe kurë të huaj“, „...42-vjeçar nga Resnja, person invalid“, „...Bane 58-vjeçar nga Ajvatovci është i sëmurë nga Alcajmeri“). Në disa kontribute dhe tekste theksohet profesioni, pozita, aftësia ose talenti që kanë personat me pengim (kryetar i Shoqatës së shurdhëve dhe i atyre me vështirësi dëgjimi, anëtar i “Vilson Maqedoni”, „...publiku e ka të njohur sipas asaj që pikturon me gojë“ e kështu me radhë).

Nga kontributet e analizuara fitohet përshtypja se personat me pengim më shpesh janë në fokusin e mediave kur duhet të kthehet vëmendja kah ndonjë problem me të cilin ato (mediat) ballafaqohen, ose kur mediat duan të theksojnë ndonjë arritje të tyre. Megjithatë, ende nuk ka “normalizim” të diskursit nga aspekti i asaj që ato të dalin si bashkëbiseduese të cilat paraqiten nga ndonjë pozitë ose rol shoqëror, përkatësisht të ndonjë teme e cila nuk është e lidhur me pengimin.

4.4. Citatet prej personave me pengim janë të rralla te përmbajtjet mediale

Në 13 tekste dhe kontribute te mediat në gjuhën maqedonase ka pasur citate nga personat me pengim, ndërsa te mediat në gjuhën shqipe te të gjitha gjashtë përmbajtjet që kanë të bëjnë me këta qytetarë nuk ka pasur asnjë citat.

Në një pjesë të teksteve të tjera, ku nuk ka citate nga personat me pengim, citohen bashkëbisedues të tjerë në temën relevante, ndërsa në disa kontribute dhe tekste aspak nuk ka bashkëbisedues. Në disa prej përmbajtjeve të analizuara gjenden vetëm disa deklarata të parafrazuara ose të transmetuara nga rrjetet sociale, ose nga institucionet, relevante për rrëfenjën.

Në të gjashtë kontributet dhe tekstet në gjuhën shqipe, citatet tërësisht mungojnë tek përmbajtja, të cilat më shpesh janë të zhanrit informativ të shkurtër.

Në disa raste, te mediat edhe në gjuhën maqedonase edhe në gjuhën shqipe citatet mungojnë për shkaqe objektive, kur bëhet fjalë për pengimet specifike të personave. Megjithatë, në më shumë raste mungon angazhimi gazetaresk që të dëgjohet edhe zëri i atyre me të cilët ka të bëjë vetë kontributi ose teksti. Ka përmbajtje në të cilat nga rrjetet sociale bartet statusi i personit me pengim, që ka bërë ndonjë arritje sportive, pa bërë media, përkatësisht gazetari, përpjekje shtesë që të vë kontakt me personin për deklaratë, për intervistë ose që në një mënyrë tjetër ta përpunojë temën.

Te kontributet dhe tekstet në gjuhën maqedonase në 18 raste toni ka qenë neutral, në 20 pozitiv, ndërsa në asnjë kontribut ose tekst nuk ka pasur ton negativ. Te mediat në gjuhën shqipe, pesë përmbajtje kanë qenë me ton neutral, ndërsa një me ton pozitiv gjatë raportimit.

5. Gjetje bazë nga intervistat e kryera

5.1. Intervista me përfaqësues të organizatave qytetare²

Në intervistat me përfaqësues të organizatave qytetare ishin përfshirë gjashtë persona, prej të cilëve tre përfaqësues të organizatave (lidhjeve) nacionale dhe tre të organizatave lokale. Sipas grupeve synimtare, ishin përfshirë katër grupet themelore, përkatësisht organizatat për personat me dëgjim të dëmtuar, me shikim të dëmtuar, me pengim trupor dhe me pengim intelektual, një organizatë - dhënës shërbimesh (teknologji asistive) për të gjitha grupet, si dhe një organizatë që s'është e personave me pengim, porse realizon aktivitete për personat me pengim. Dy persona të intervistuar janë me pengim, ndërsa dy janë anëtarë të familjes ku ka person me pengim.

Në lidhje me organizimin e punës me media, nga intervistat mund të nxirret përfundimi se organizatat qytetare janë të vetëdijshme për rëndësinë e mediave dhe për leverditë nga bashkëpunimi me to. Një pjesë e organizatave janë të trajnuara (në bazë filllore) se si të bashkëpunojnë me mediat dhe dinë e shfrytëzojnë **vegla për komunikim me mediat dhe me gazetarët: deklarata, komunikata, intervista dhe pjesëmarrje në emisione, vizita të gazetarëve,**

“

„...Personat me pengim duhet të jenë të përfshirë në aktivitetet e shoqërisë dhe të potencohen (me shembuj) kualitetet dhe aftësitë e tyre. Me atë pjesërisht do të thyhej iluzioni se ata nuk mund të bëjnë gjëra të cilat njerëzit “normalë” mund t'i bëjnë.”

**Aleksandar
Panajotov,
Natura MK
Shkup**

”

² Emrat e të intervistuarve janë theksuar në fund të tekstit, te pjesa:
Lista e intervistave.



„Trajtimi medial duhet të kontribuojë për rritjen e nivelit të vetëdijes publike të qytetarëve për nevojat e personave me invaliditet, e sidomos të atyre qytetarëve që krijojnë politika përmes angazhimit të tyre politik. Vetëm kështu mund të shpresojmë në inkluzion të plotë të personave me invaliditet në rrjedhat shoqërore dhe njohjen e dallimeve.“

Branimir Jovanovski,
Lidhja Nationale e Personave me Invaliditet Trupor të Maqedonisë – Mobilnost Makedonija



press-konferenca e të ngjashme. Komunikimi me mediat zhvillohet përmes ftesave dhe komunikatave për media për shënimin e ngjarjeve, projekteve, iniciativave për realizimin e të drejtave të caktuara, si dhe pjesëmarrje në emisione (më shpesh në programet e mëngjesit).

Organizatave në të shumtën e rasteve **nuk kanë resurse që të sigurojnë personin profesional**, i cili do t'ua organizonte dhe do t'ua udhëhiqte punën me mediat, kështu që këtë punë më shpesh e bëjnë kryetarët, menaxhuesit ose personat e punësuar, të cilët nuk janë profesionistë në sferën e PR (Public relations/marrëdhënie me publikun).

Përfaqësuesit e organizatave theksojnë se në të shumtën e rasteve **organizatat janë ato që i iniciojnë kontaktet me mediat** dhe përpiqen që në kohë t'i njoftojnë për ndonjë aktivitet, projekt, ngjarje, duke shfrytëzuar me këtë rast njohuritë nga trajnimet për punë me media. Organizatat konsiderojnë se kjo ka gjetur jehonë dhe se përgjigjja prej mediave është pozitive dhe e kënaqshme. Një pjesë e organizatave kanë vënë **raporte miqësore me gazetarë të caktuar, me të cilët janë në komunikim të vazhdueshëm.**

Përfaqësuesit e organizatave konsiderojnë se gazetarët, marrë në përgjithësi, **pamjaftueshëm i kuptojnë problemet dhe sfidat e personave me pengim dhe nuk kanë njohuri ose informacione të mjaftueshme, përveç nëse nuk kanë përvojë direkte, përkatësisht nëse ndonjë i afërm i tyre nuk është i prekur nga pengimi.** Informimet e tyre, lajmet, reportazhet dhe publikimet e tyre shpeshherë janë të kufizuara dhe të zbehta, pa e thelluar tematikën me njohuri të zgjeruara, me koment in e tyre e të ngjashme. Ndodh që gazetarët të vijnë në ngjarje të painformuar dhe të papërgatitur për të bërë rrëfenjë të mirë; megjithatë ka edhe gazetarë që kanë përvojë të madhe në informim për tema që janë të lidhura me personat me pengim dhe bashkëpunimi me ta është me rëndësi të veçantë. **Organizatave lokale kanë problem në komunikim me mediat nacionale** - edhe përkundër përpjekjes për të vënë kontaktin me to, ato shumë dobët raportojnë për aktivitete në nivel lokal.

5.2. Intervista me përfaqësues të institucioneve shtetërore relevante³

Në intervistat me përfaqësues të institucioneve shtetërore relevante ishin përfshirë dy përfaqësues qeveritarë, dy përfaqësues të Ministrisë së Punës dhe të Politikës Sociale dhe një përfaqësues i Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencës, si dhe një përfaqësues nga pushtetet lokale. Tre prej tyre janë persona me pengim.

Përfaqësuesit e institucioneve shtetërore kryesisht kanë përvojë pozitive nga bashkëpunimi me mediat. Kohëve të fundit gazetarët janë korrektë dhe të hapur për bashkëpunim, mirëpo një pjesë e madhe e tyre janë të papërgatitur në temat për të cilat raportojnë ose bëjnë rrëfenja, gjë që është faktor rëndues për transmetim cilësor të informacioneve. Sipas tyre, gazetarët pamjaftueshëm janë të njohur me të drejtat, me problemet dhe nevojat e personave me pengim. Përdoret **terminologji e vjetruar, e cila ndikon ofendueshëm, për shkak se theksohet invaliditeti, e jo mundësitë e personit**. Një pjesë e teksteve dhe e tregimeve bazohen në qasjen “mëshiruese” dhe pothuajse gjithnjë kërkohet nga institucionet “vullnet që të ndihmohet”, në vend se të drejtohet një porosi e qartë se personat me pengim kanë të drejta të cilat shteti është i obliguar t’i sigurojë dhe t’i realizojë.

Përfaqësuesit e intervistuar vënë në dukje se **mungon gazetaria hulumtuese, e sidomos se mungojnë emisione me interes publik, si dhe edukimi i gazetarëve**, që do të ishte i vazhdueshëm, në vend të trajnimeve të njëhershme dhe njëditore.

Përfaqësuesit e intervistuar të institucioneve shtetërore theksojnë se nevojitet përfshirje më e madhe e temave që janë të rëndësishme për personat me pengim në media,



„Respektimi i dinjitetit njerëzor dhe i të drejtave të njeriut të të gjithë njerëzve, përfshi edhe pjesëtarët e grupeve të marginalizuara, është obligim i gazetarëve. Gazetarët duhet të jenë veçanërisht të vëmendshëm gjatë përdorimit të termave për të shënuar bashkësitë dhe grupet e diskriminuara, për shkak se njëra prej formave të shtrira të diskriminimit është identifikimi lingistik negativ dhe mospërfillës. Sfidë e veçantë etike është përdorimi i termave respektues për njerëzit me pengim, për shkak se gjuha mosrespektuese mund të shkaktojë ndjesinë e përjashtimit.“

**Teodor Bogoevski,
Këshilltar për Persona
me Pengim në Zyren e
Kryetarit të Qeverisë
së Republikës
së Maqedonisë
së Veriut**



³ Emrat e të intervistuarve janë theksuar në fund të tekstit, te pjesa: Lista e intervistave.



*„Inkluzion në hapësirën
mediale është kur do
ta shoh (për shembull)
personin me sindromën*

*Daun se si është
prezantues lajmesh
në (ndonjë) televizion
nacional, udhëheqës
i kontakt-emisionit,
i kuizit e të ngjashme.*

*Vetëm atëherë do
të mund të flasim
për pjesëmarrje të
personave me pengim
në hapësirën mediale;
vetëm ashtu do të
adaptohem me praninë
e tyre si diçka shumë
të natyrshme, në
të kundërtën flasim
për segregacion.*

*‘Emisioneve speciale’
me ‘gazetarë specialë’
lirisht mund t’u vëmë
shenjën ‘vetëm për
persona me pengim,
lejuar mbi 15 vjeç’ dhe
me këtë ta paraqesim
gjendjen e përgjithshme
të inkluzionit në RMV.”*

**Mirjana Zlatanova,
Këshilltare në
Ministrinë e Arsimit
dhe të Shkencës.**



me të cilën do të ndikohej edhe tek vetëdija publike dhe tek qasja e përgjithshme ndaj këtyre personave, por jo të shkruhet se duhet “mbledhur donacione”, “t’i ndihmojmë personit” e kështu me radhë, por të shkruhet për mundësitë dhe potencialet e personave - atëherë edhe opinionin publik, edhe institucionet arsimore, edhe punëdhënësit do të sensibilizohen. Gjithashtu, nevojitet që të tejkalohen pamundësitë për të hyrë në pjesën më të madhe të studiove dhe të shtëpive televizive, e cila në mënyrë plotësuese e kufizon pjesëmarrjen e personave me pengim në media. Mungojnë emisione të cilat do t’i kishin theksuar kualitetet e jetës me pengim, ku do të ishte folur për sukseset, pa e theksuar me këtë rast pengimin, i cili në çdo rast do të ishte vërejtur nga shikuesit.

Përvojë negative është qasja e përgjithshme e gazetarëve mbi bazë mëshiruese ndaj personave me pengim. Kjo në të shumtën e rasteve reflektohet me qasjen kur kërkon që ata patjetër të ndihmohen, e nuk paraqiten mundësitë dhe kapacitetet e personave. Në të shumtën e rasteve rrëfenjat gazetareske paraqesin persona me pengim dhe raste sociale që jetojnë në varfëri, tregime këto të cilat janë për të ta thyer shpirtin, që shkaktojnë vetëm keqardhje tek publiku, pa u dhënë vend të mjaftueshëm rrëfenjave për personat me pengim të cilët janë të suksesshëm edhe në planin profesional, edhe në planin personal.

Plus kësaj, përfaqësuesit e institucioneve dëftyen se dukuri negative janë lajmet e rreme, gjithnjë e më të shpeshta, të cilat u marrin një pjesë të madhe të kohës institucioneve në dëshmimin e të vërtetës. Gjithashtu, një pjesë e madhe e mediave janë të lidhura me ndonjë parti politike dhe punojnë për agjendat ditore-politike të partive ose bizneseve të caktuara.

Në lidhje me përvojën nga bashkëpunimi me organizatat qytetare, përfaqësuesit e institucioneve shtetërore theksuan se përcaktim i përgjithshëm i shtetit është decentralizimi dhe pluralizimi i sistemit të mbrojtjes sociale, përkatësisht mundësimi dhe përfshirja e organizatave joqeveritare që të veprojnë në kuadër të sistemit dhe t’u japin shërbime dhe servise grupeve të tyre të synuara. Organizatat e personave me pengim kanë potencial

dhe meqë vijnë nga baza, ato më së miri i dinë nevojat e personave me pengim, ato janë “pasuri informacionesh” që i duhen Qeverisë. Ka organizata që janë të mira në atë çka punojnë, që janë më të zhvilluara dhe ndjekin trende evropiane, mirëpo ka edhe organizata më të vogla të cilat nuk janë mjaftueshëm të informuara dhe janë të paqëndrueshme, edhe përkundër pikësyzimit të tyre të mirë për të realizuar ndonjë program ose shërbim të ri. Organizatat joqeveritare janë shumë domethënëse për sistemin si dhënëse të shërbimeve të reja për personat me pengim, siç janë qendrat ditore dhe asistencat personale, ndërkohë që gjithashtu përfshihen dhe konsultohen në proceset për nxjerrjen e zgjidhjeve të reja ligjore që kanë të bëjnë me të drejtat e personave me pengim.

5.3. Intervista me përfaqësuesit e mediave⁴

Në intervistat me përfaqësuesit e mediave ishin përfshirë gjashtë gazetarë, prej të cilëve tre punojnë në televizionet nacionale TVM (MTB), TV Alsat-M dhe TV 24, dy në radiot nacionale: Radioja Maqedonase (Македонско радио) dhe Kanal 77 dhe një përfaqësues ueb-portali. Një prej të intervistuarve është person me pengim dhe një person është bijë e prindit me dëgjim të dëmtuar dhe është interpretues i gjuhës së shenjave. Tre gazetarë direkt ishin të kyçur në implementimin e aktiviteteve në kuadër të projektit “Pengimi është çështje e perceptimit”.

Në lidhje me përvojën rreth raportimit për persona me pengim në përgjithësi në shtet, të gjithë gazetarët e intervistuar janë ose kanë qenë të angazhuar në përgatitjen e rrëfjave, kontributeve, emisioneve për personat me pengim, ndërsa një pjesë janë fitues të shpërblimeve për punën e tyre kushtuar personave me pengim. Përgjithësisht, gazetarët konsiderojnë se mediat pamjaftueshëm i ndjekin temat që janë domethënëse për personat me pengim, ndërsa barrierë e madhe është mospasja e planit strategjik që do të ishte në interes të të dyja palëve. Që të përmirësohet dukja e personave me pengim në hapësirën mediale, gazetarët konsiderojnë

“

„Është e nevojshme që edhe vetë qytetarët me pengim të inkurajohen dhe të jenë më të zëshëm. Kjo do të thotë se duhet të jenë me disponim kritik për atë çka i trishton në përditshmërinë e tyre.“

Vanja Micevska,
gazetare, Radio
Kanal 77, radio në
nivel nacional.

”

⁴ Emrat e të intervistuarve janë theksuar në fund të tekstit, te pjesa:
Lista e intervistave.



„Mediat dhe gazetarët mund t'u ndihmojnë shumë personave me pengim në luftën e të drejtave të njeriut për ta, sidomos nëse janë të udhëzuar në atë se si zbatohen ligjet, programet dhe strategjitë ekzistuese. Që të sigurojnë informacione për të gjithë në bashkësi, e jo vetëm për ata që janë shumicë, është e domosdoshme që mediat ta afirmojnë dallimin në redaksi, duke punësuar edhe gazetarë me pengim. Është e domosdoshme edhe përshtatja e përmbajtjeve mediale, që ato të jenë me qasje edhe për personat me pengim.“

Çedomir Shopiq,
gazetar në Radio e
Maqedonisë, emisioni
për persona me pengim
„Panta Rhei“.



se duhet të ndryshojë vetëdija tek eprorët në media, se fuqia që kanë mediat publike duhet të shfrytëzohet që t'u tregohet qytetarëve se me çfarë sfidash ballafaqohen bashkëqytetarët e tyre që janë me pengim. Kjo është sidomos e rëndësishme, për shkak se çështja e inkluzionit jo gjithnjë është e lidhur me sistemin institucional, por me atë shoqëror përgjithësisht. Për këtë shkak, punonjësit e medias duhet jo vetëm të informojnë, por edhe të edukojnë për këto çështje.

Gazetarët e intervistuar kanë tjetër qasje ndaj shkrimeve për personat me pengim edhe në dallim prej më parë. Në çështjet e pengimit gjithnjë e më shumë shikojnë si në çështje të të drejtave të njeriut përmes objektivitetit të modelit social, bëhet kujdes për objektivitetin gjatë raportimit, kontributet ose trajtesat janë të qëruara nga emocionaliteti, gjithnjë e më tepër bëhet kujdes për terminologjinë, përpunohen tema pozitive me bashkëbisedues që janë të gatshëm për të folur për nevojat dhe të drejtat e tyre. Praktika e mirë gazetareske në raportim është “hapja” e të gjitha përmbajtjeve programore të mediave për personat me pengim, përkatësisht rrënimi i mitit se ata persona patjetër duhet të jenë të pranishëm vetëm në emisionet e specializuara (për shembull, „Светот на тишината“ - Bota e heshtjes dhe „Петтиот ангел“ - Engjëlli i pestë në MTB - shqip: TVM) dhe përfshirja e tyre në programin arsimor, informativ dhe kulturor të mediave.

Gazetarët dëftojnë se për punën e tyre gjithnjë kanë mbështetje nga redaktorët dhe redaksitë dhe gjithnjë e kanë pasur lirinë e nevojshme gazetareske.

6. Rekomandime

1. Në mediat në gjuhën maqedonase dhe shqipe numri i kontributeve dhe teksteve që kanë të bëjnë me personat me pengim është i pamjaftueshëm dhe duhet të rritet, sidomos te disa media. Mbulimi i temave që lidhen me personat me pengim dukshëm duhet të bëhet më mirë edhe në lidhje me kuantitetin edhe në lidhje me kualitetin, sidomos te mediat në gjuhën shqipe.
2. Temat që prekin personat me pengim në të shumtën e rasteve janë të mbuluara përmes lajmeve, raporteve dhe rrëfenjave sociale, më rrallë përmes zhanreve më të gjata, analitike. Ka nevojë për angazhim më të madh gazetaresk dhe më shumë iniciativë nga ana e gazetarëve në identifikimin e temave që lidhen me personat me pengim dhe mbulimi konzistent i tyre, gjithnjë deri në shkaktimin e reaksioneve nga institucionet dhe zgjidhjen e problemeve eventuale.
3. Mediat ende përdorin terminologji të vjetruar, si: persona me nevoja të veçanta, persona me invaliditet, persona invalidë, invalidë, persona me hendikep, në vend se: persona me pengim, që është një emërtim më adekuat dhe shoqërisht më i pranuar. Është e nevojshme që të ngrihet vetëdija e gazetarëve dhe e redaktorëve për përdorimin e terminologjisë korrekte në lidhje me personat me pengim, ndërsa shoqëria qytetare do të duhet të ofrojë mbështetje në këtë proces.
4. Personat me pengim rrallë gjenden si bashkëbisedues në përmbajtjet gazetareske, e sidomos te mediat në gjuhën shqipe. E ngjashme është situata edhe me organizatat qytetare që i përfaqësojnë këta persona, ose që, ndërkaq, kanë ndonjë farë lloji të ekspertizës në lidhje me personat me pengim. Gazetarët duhet të përfshijnë më shumë burime në përgatitjen e tregimeve që kanë të bëjnë me personat me pengim, që të sigurohet potencimi afirmativ i ekspertizave të personave me pengim.

5. Gjatë raportimit për personat me pengim, gazetarët duhet ta nxitin diskursin e "normalizimit" në lidhje me këto tema. Kjo nënkupton raportim jo vetëm në rastet kur duhen theksuar problemet, sfidat ose arritjet e këtyre njerëzve, por përmes zbatimit të parimeve të "gazetarisë inkluzive" ata do të duhet të jenë të përfshirë në tema dhe përmbajtje të ndryshme të cilat i prodhojnë mediat.
6. Mediat duhet ta paraqesin ndryshesën në kuadër të temave që kanë të bëjnë me personat me pengim, e sidomos të grave dhe të fëmijëve me pengim, si dhe të grupeve shumëfish të marginalizuara, siç janë pjesëtarët me pengim të grupeve etnike. Kjo i kontribuon asaj që te këta qytetarë të shikohet si te disa që kanë të njëjtat të drejta dhe nevoja si edhe të tjerët.
7. Që të përmirësohet qasja gazetareske dhe mediale ndaj temave që kanë të bëjnë me personat me pengim, është e nevojshme që mediat të lënë më shumë hapësirë në programet e tyre për emetimin e temave, të lajmeve ose të informacioneve që i përfshijnë personat me pengim. Gazetarët duhet të kenë qasje drejt personave me pengim nga aspekti i parimeve të njëjtësisë dhe të inkluzionit në të gjitha segmentet e jetesës shoqërore, e jo mbi bazë të mëshirimit dhe të bamirësisë.
8. Mediat më shumë duhet t'i prezantojnë mundësitë dhe kapacitetet e personave me pengim, ndërsa problemet me të cilat ballafaqohen ata duhet të marrin anë drejt kërkimit të përgjigjeve dhe të zgjidhjeve nga institucionet, nga qytetarët dhe opinioni publik. Mediat duhet të sigurojnë qasje për personat me pengim në objektet e tyre. Edhe më e rëndësishme është që mediat të mundësojnë që përmbajtjet e tyre të jenë në formate që janë të përshtatshme për personat me pengim të llojeve të ndryshme.
9. Është e nevojshme që të organizohen më shumë trajnime gjithëpërfshirëse dhe të vazhdueshme për gazetarë, në të cilat ata thelbësisht do të ishin njohur me problemet, me sfidat, me të drejtat dhe përgjithësisht me sferën që ka të bëjë me personat me pengim. Në këtë mënyrë do të ishte mundësuar praktikimi i gazetarisë inkluzive nëpër redaksi, përmes së cilës do të ishte përparuar edhe tabloja e përgjithshme dhe pranimi i personave me pengim në shoqëri.
10. Temat e lidhura me grupet e marginalizuara, përfshi edhe personat me pengim, duhet të bëhen pjesë e programeve mësimore në fakultetet e gazetarisë, me qëllim që gazetarët e ardhshëm më afër të njihen me këtë sferë. Në këtë drejtim mund të nxitet bashkëpunimi midis fakulteteve dhe organizatave qytetare, përfaqësuesit e të cilave mund të bartin dituri, ekspertizë dhe të propozojnë resurse nga kjo sferë.

11. Bashkëpunimi midis mediave dhe organizatave qytetare në mënyrë plotësuese duhet të përparohet dhe të zhvillohet, përmes mekanizmave dhe aktiviteteve të ndryshme. Mediat mund të gjenerojnë tema, ide, ekspertizë nga organizatat qytetare, të cilave, ndërkaq, mediat u nevojiten që më mirë të promovohen, të paraqesin punën, anëtarët, zotimet dhe iniciativat e tyre.
12. Është i nevojshëm komunikimi më i shpeshtë, por edhe paraqitja më e shpeshtë dhe “më agresive” e organizatave qytetare që i përfaqësojnë personat me pengim përmes mediave, në përpjekje për t’ia dalë që t’i realizojnë kërkesat për përmirësimin e të drejtave dhe të pozitës të këtyre qytetarëve, për shkak se mediat mund të kontribuojnë që çështje të caktuara më shpejt të shqyrtohen dhe të zgjidhen nga ana e politikanëve. Informimi objektiv është me rëndësi të jashtëzakonshme në këtë proces.

Lista e intervistave

Përfaqësues të organizatave qytetare:

1. **Goran Sačevski**, aktivist në Qendrën për Mbështetjen e Personave me Pengim Intelektual - Porosia, Strumicë
2. **Margarita Gulevska**, Drejtore e Bashkimit për Teknologji Asistive „Otvorete gi prozorcite“ (Hapni Dritaret)
3. **Sterja Dimov**, Sekretar i Përgjithshëm i Lidhjes Nacionale të Personave të Verbër të Maqedonisë
4. **Tomica Stojanovski**, Kryetar i Lidhjes Nacionale të Shurdhëve dhe të Veshrëndëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut
5. **Aleksandar Panajotov**, Natura MK Shkup
6. **Branimir Jovanovski**, Kryetar i Lidhjes Nacionale të Personave me Invaliditet Trupor të Maqedonisë – Mobilnost Makedonija (Mobiliteti Maqedoni).

Përfaqësues të institucioneve shtetërore relevante:

1. **Dushan Tomshiq**, Këshilltar i Ministres së Punës dhe të Politikës Sociale dhe Koordinator për Zhvillimin e Shërbimeve Sociale në Ministrinë e Punës dhe të Politikës Sociale
2. **Lidia Kërstevska Dojčinovska**, Këshilltare e Shtetit në Zyrën e Kryetarit të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe anëtar i Trupit Koordinues Nacional për Implementimin e Konventës së KB për të Drejtat e Personave me Pengim
3. **Teodor Bogoevski**, Këshilltar për Persona me Pengim në Zyrën e Kryetarit të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut
4. **Vangel Tërkalanov**, Këshilltar i Ministres së Punës dhe të Politikës Sociale
5. **Mirjana Zllatanova**, Këshilltar për Nxënës me Nevoja të Veçanta Arsimore në Sektorin për Arsim të Mesëm, Arsim për të Rritur dhe Mësim Jetik në kuadër të Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencës
6. **Eleonora Pančevska Nikollovska**, Udhëheqëse në Seksionin e Mbrojtjes Sociale, Shëndetësore dhe Fëmijërore – Sektori i Veprimtarive Publike në Qytetin e Shkupit.

Përfaqësues të mediave:

1. **Hekuran Aqifi**, gazetar, emisioni „360 Stepni“ (360 Shkallë) në TV Alsat-M
2. **Zoran Andonov**, gazetar, portali „Sakam da kazam“ (Dua të dëftej, SDK.mk)
3. **Vanja Micevska**, gazetare, Radio Kanal 77, radio në nivel nacional
4. **Maria Bashëska Stojanovska**, gazetare dhe interpretuese e gjuhës së shenjave në Servisi Publik Radiodifuziv Makedonska Radio Televizija
5. **Sunai Sabrioski**, gazetar, TV 24
6. **Çedomir Shopkiq**, gazetar në Radio e Maqedonisë, emisioni për persona me pengim „Panta Rhei“.

Ky publikim është përgatitur nga Instituti i Diversitetit të Medias (MDI), Media Instituti Maqedoni (MIM) dhe Këshilli Nacional i Organizatave Invalidore të Maqedonisë (KNOIM), si pjesë e projektit “Pengimi është çështje e perceptimit”, që është financuar nga Bashkimi Evropian.



МАКЕДОНСКИ
ИНСТИТУТ
ЗА МЕДИУМИ



Ky publikim është i përgatitur me mbështetje financiare nga Bashkimi Evropian. Përbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi vetëm e Institutit të Diversitetit të Medias (MDI) dhe në asnjë mënyrë nuk i pasqyron pikëpamjet e Bashkimit Evropian.